



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 1570/3 prot

Elbasan, më 15.06.2024

VENDIM

Nr 36, datë 15.06.2024

Për

trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," i ndryshuar, VBA nr 35 datë 06.11.2023 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024", Relacionit "Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024", paraqitur nga Administratori z. Eljan Hoxha, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë bursë financiare 7 studentë me kriterë të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 14 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 2 studentë, sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Vendimarrja të zbatohet pas konfirmimit të statusit të studentëve.
Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durmishi